LIGJ
Nr.10 102, datë 26.3.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR STATUSIN E ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT, TË PËRFAQËSUESVE KOMBËTARË DHE PERSONELIT NDËRKOMBËTAR"

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar", bërë në Otava më 19 shtator 1951.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE
MBI STATUSIN E ORGANIZATËS SË ATLANTIKUT TË VERIUT, PËRFAQËSUESIT VENDAS DHE PERSONELIT NDËRKOMBËTAR

Shtetet nënshkruese në këtë Marrëveshje,

duke pasur parasysh se për ushtrimin e funksioneve të tyre dhe për plotësimin e qëllimeve të tyre është e nevojshme që Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, personeli i saj ndërkombëtar dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që ndjekin takimet e saj duhet të kenë statusin e përcaktuar në vazhdim,

kanë rënë dakord për sa vijon:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në këtë Marrëveshje,

a) "Organizata" nënkupton Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut që përbëhet nga Këshilli dhe organet e tij ndihmëse.

b) "Këshilli" nënkupton këshillin e krijuar sipas nenit IX të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Përfaqësuesit në Këshill;

c) "organe ndihmëse" nënkupton çdo organ, komitet apo shërbim të ngritur nga Këshilli ose nën autoritetin e tij, përveç atyre ndaj të cilave nuk zbatohet kjo Marrëveshje, në përputhje me Nenin II;

d) "Kryetar i përfaqësuesve në Këshill" përfshin, në mungesë të tij, nënkryetarin që vepron për të.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet për asnjë shtab ushtarak të ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe për asnjë organ tjetër ushtarak, përveç kur këshilli vendos ndryshe.

Neni 3

Organizata dhe Shtetet Anëtare do të bashkëpunojnë në çdo kohë për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë, për të siguruar zbatimin e rregulloreve të policisë dhe për të parandaluar ndodhjen e çfarëdo abuzimi në lidhje me imunitetet dhe privilegjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Në qoftë se cilido Shtet Anëtar quan se ka pasur një abuzim me cilindo imunitet apo privilegj të dhënë sipas kësaj Marrëveshje, do të mbahen diskutime ndërmjet atij Shteti dhe Organizatës ose ndërmjet Shteteve të interesuara, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një abuzim i tillë dhe nëse është kështu, për të bërë përpjekje për të siguruar që mos të ketë përsëritje të tij. Pavarësisht nga sa u tha më sipër apo nga cilado dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshje, një Shtet Anëtar i cili quan se cilido person ka abuzuar me privilegjin e tij të vendbanimit apo me çdo imunitet apo privilegj tjetër të dhënë sipas kësaj Marrëveshje mund t'i kërkojë këtij personi që të largohet nga territori i tij.

PJESA II
ORGANIZATA

Neni 4

Organizata do të ketë personalitet juridik; ajo do të ketë aftësinë për të përfunduar kontrata, për të blerë dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe për të nisur procedime ligjore.

Neni 5

Organizata, pasuritë dhe pronat e saj, kudo që të ndodhen e nga kushdo që të mbahen, do të gëzojnë imunitet nga çdo formë e procesit ligjor përveç kur në çdo rast të veçantë Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill, duke vepruar në emër të organizatës, mund të autorizojë shprehimisht heqjen e këtij imuniteti. Vetëkuptohet sidoqoftë, se asnjë heqje e imunitetit nuk do të shtrihet deri në ndonjë mase ekzekutimi apo ndalimi të pasurisë.

Neni 6

Mjediset e organizatës do të jenë të paprekshme. Pasuritë dhe pronat e saj, kudo që të ndodhen e nga kushdo që të mbahen, do të gëzojnë imunitet nga kontrollet, sekuestrimet, konfiskimet, shpronësimet apo nga çdo formë tjetër ndërhyrje.

Neni 7

Arkivat e organizatës dhe të gjitha dokumentet që i përkasin asaj apo që mbahen nga ajo do të jenë të paprekshme, kudo që të ndodhen.

Neni 8

1. Pa u kufizuar nga kontrollet financiare, rregulloret apo moratoriumet e çfarëdo lloji,
a) Organizata mund të mbajë valutë të çfarëdo lloji dhe të operojë llogari në çfarëdo lloj

valute;

b) Organizata mund të transferojë lirisht fondet e saj nga një vend në një tjetër apo brenda cilitdo vend dhe mund të këmbejë çdo valutë që ajo mban në çfarëdo lloj valute tjetër në kursin më të favorshëm zyrtar të këmbimit për një shitje apo blerje siç mund të jetë rasti.

2. Në ushtrimin e të drejtave të saj sipas paragrafit 1 më lart, organizata do t'i japë vëmendjen e duhur çdo parashtrimi të bërë nga cilido Shtet Anëtar dhe do t'i japë fuqi parashtrimeve të tilla për aq sa është e arsyeshme për të vepruar kështu.

Neni 9

Organizata, pasuritë, të ardhurat dhe pronat e tjera të saj do të përjashtohen:

a) nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta; Organizata sidoqoftë nuk do të kërkojë përjashtim nga tarifat, taksat apo detyrimet që nuk janë tjetër veçse tarifa për shërbime komunale publike;

b)) nga të gjitha detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore mbi importet dhe eksportet në lidhje me artikujt e importuar apo eksportuar nga Organizata për përdorimin e saj zyrtar; artikujt e importuar sipas përjashtimeve të tilla nuk do të disponohen, as me shitje e as me dhurim, në vendin në të cilin ato importohen përveçse sipas kushteve të miratuara nga Qeveria e atij vendi;

c)) nga të gjitha detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore mbi importet dhe eksportet në lidhje me publikimet e saj.

Neni 10

Ndërsa organizata, si rregull i përgjithshëm, nuk do të kërkojë përjashtim nga detyrimet për taksat indirekte dhe nga taksat mbi shitjen e pasurisë të luajtshme apo të paluajtshme që përbëjnë pjesë të çmimit për tu paguar, sidoqoftë, kur Organizata është duke bërë blerje të rëndësishme për përdorimin zyrtar të pronave mbi të cilat janë vënë apo është e mundur të vihen detyrimet dhe taksa të tilla, Shtetet Anëtare kurdoherë që është e mundur do të bëjnë rregullimet e përshtatshme administrative për shlyerjen apo kthimin e shumës së detyrimit apo taksës.

Neni 11

1. Asnjë censurë nuk do të zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare dhe komunikimeve të tjera zyrtare të Organizatës.

2. Organizata do të ketë të drejtën të përdorë kode si edhe të dërgojë e marrë korrespondencën me korrier apo në çanta të vulosura, të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si korrierët dhe çantat diplomatike.

3. Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet sikur pengon marrjen e masave paraprake të përshtatshme të sigurisë siç do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet një Shteti Anëtar dhe Këshillit që vepron në emër të organizatës.

PJESA III
PËRFAQËSUESIT E SHTETEVE ANËTARE

Neni 12

Çdo person i përcaktuar nga një Shtet Anëtar si përfaqësuesi i tij kryesor i përhershëm në organizatë në territorin e një Shteti tjetër Anëtar, dhe anëtarë të tjerë të personelit të tij zyrtar që banojnë në atë territor siç mund të bihet dakord ndërmjet Shtetit që i ka caktuar ata dhe organizatës, si edhe ndërmjet organizatës dhe shtetit në të cilën ata do të banojnë, do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet që i janë dhënë përfaqësuesve diplomatikë dhe personelit të tyre zyrtar

në një gradë të krahasueshme.

Neni 13

1. Cilido përfaqësues i një Shteti Anëtar në Këshill ose cilindo nga organet e tij ndihmëse i cili nuk mbulohet nga neni XII, ndërsa është i pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e detyrave të tij, gëzon privilegjet dhe imunitetet si vijon:

a) të njëjtin imunitet nga arrestimi apo ndalimi personal si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

b) në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të veprimeve të bëra nga ai në cilësinë e tij zyrtare, imunitet nga procesi ligjor;

c) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë e dërguar dokumente apo korrespondencë me anë të korrierit apo në çanta të vulosura;

e) të njëjtin përjashtim në lidhje me atë vetë dhe me bashkëshorten e tij nga kufizimet mbi imigrimin, regjistrimin e të huajve dhe detyrimet për shërbim kombëtar si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

f) të njëjtat lehtësira në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj siç u janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

g) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tij vetjake si ai që i është dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

h) të drejtën për të importuar pa paguar taksë doganore mobiliet dhe sendet e tij vetjake në kohën e mbërritjes së parë për të marrë detyrën e tij në vendin në fjalë, dhe me përfundimin e funksioneve të tij në atë vend, për t'i rieksportuar këto mobilie dhe sende pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit në të cilin është duke u ushtruar e drejta;

i) të drejtën për të importuar përkohësisht pa paguar taksë doganore mjetin e tij privat të motorizuar për përdorimin e tij vetjak dhe në vijim për ta rieksportuar një mjet të tillë pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit të interesuar.

2. Atje ku parashikimi ligjor i çdo forme taksimi varet nga vendbanimi, periudha gjatë së cilës një përfaqësues ndaj të cilit zbatohet ky Nen është i pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e detyrave të tij, nuk do të quhet si periudhë banimi. Në veçanti, ai do të përjashtohet nga taksimi mbi pagën dhe shpërblimet e tij zyrtare gjatë periudhave të tilla në detyrë.

3. Në këtë nen "përfaqësues" do të quhet se përfshin të gjithë përfaqësuesit, këshilltarët dhe ekspertët teknikë të delegacioneve. Secili Shtet Anëtar do t'i komunikojë Shteteve të tjera Anëtare të interesuara, nëse ato e kërkojnë këtë gjë, emrat e përfaqësuesve të tij ndaj të cilëve zbatohet ky nen dhe kohëzgjatjen e mundshme të qëndrimit të tyre në territoret e këtyre shteteve.

Neni 14

Personelit zyrtar mbështetës që shoqëron një përfaqësues të një Shteti Anëtar që nuk mbulohen nga nenet XII ose XIII, ndërsa janë të pranishëm në territorin e një Shteti tjetër Anëtar për kryerjen e funksioneve të tyre, do t'i jepen privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në paragrafin 1 b., c., e., f., h. dhe i., si edhe në paragrafin 2 të nenit XIII.

Neni 15

Privilegjet dhe imunitetet i jepen përfaqësuesve të Shteteve Anëtare dhe personelit të tyre jo për përfitimin personal të vetë individëve por me qëllim që të ruajnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut. Si rrjedhim, një Shtet Anëtar ka jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin për të hequr imunitetin e përfaqësuesve të tij dhe anëtarëve të personelit të tyre në cilindo rast kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar qëllimet për të cilat imuniteti është dhënë.

Neni 16

Dispozitat e neneve nga XII deri në XIV më lart nuk do t'i kërkojnë asnjë shteti që të japë cilindo nga privilegjet dhe imunitetet e referuara aty ndaj cilitdo person që është shtetas i vet apo ndaj cilitdo person si përfaqësuesi i tij apo anëtar i personelit të këtij përfaqësuesi.

PJESA IV
PERSONELI NDËRKOMBËTAR DHE EKSPERTËT NË MISIONE PËR ORGANIZATËN

Neni 17

Kategoritë e zyrtarëve të organizatës ndaj të cilëve zbatohen nenet nga XVIII deri në XX do të bihen dakord ndërmjet Kryetarit të Përfaqësuesve në Këshill dhe secilit nga Shtetet Anëtare të interesuara. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill do t'i komunikojë Shteteve Anëtare emrat e zyrtarëve të përfshirë në këto kategori.

Neni 18

Zyrtarët e organizatës për të cilët është rënë dakord sipas nenit XVII:

a) do të gëzojnë imunitet nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të autoritetit të tyre;

b) do tu jepen, së bashku me bashkëshortet e tyre dhe me anëtarët e familjes së tyre të ngushtë që banojnë me ta e që varen prej tyre, të njëjtat imunitete nga kufizimet mbi imigrimin dhe regjistrimin e të huajve siç u jepen personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

c) do tu jepen të njëjtat lehtësira në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj siç u janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

d) do tu jepen të njëjtat lehtësira, së bashku me bashkëshortet e tyre dhe me anëtarët e familjes së tyre të ngushtë që banojnë me ta e që varen prej tyre, për riatdhesimin në kohë krizash ndërkombëtare si ato që i janë dhënë personelit diplomatik në një gradë të krahasueshme;

e) do të kenë të drejtën për të importuar pa paguar taksë doganore mobiliet dhe sendet e tyre në kohën e mbërritjes së parë për të marrë detyrën e tyre në vendin në fjalë, dhe me përfundimin e funksioneve të tyre në atë vend, për t'i rieksportuar këto mobilie dhe sende pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme Qeveria e vendit në të cilin është duke u ushtruar e drejta;

f) do të kenë të drejtën për të importuar përkohësisht pa paguar taksë doganore mjetet e tyre private të motorizuara për përdorimin e tyre vetjak dhe në vijim për t'i rieksportuar këto mjete pa paguar taksë doganore, duke iu nënshtruar në secilin rast kushteve të tilla që mund të vlerësojë si të nevojshme qeveria e vendit të interesuar.

Neni 19

Zyrtarët e organizatës për të cilët është rënë dakord sipas nenit XVII do të përjashtohen nga taksimi mbi pagat dhe shpërblimet që u paguhen atyre nga Organizata në cilësinë e tyre si zyrtarë të tillë. Cilido Shtet Anëtar mundet që, sidoqoftë, të arrijë një rregullim me Këshillin që vepron në emër të organizatës përmes së cilës ky Shtet Anëtar do të punësojë dhe caktojë në organizatë të gjithë shtetasit e vet (përveç, nëse Shteti Anëtar kështu dëshiron, çdo personi banues jo i përhershëm brenda territorit të tij) që do të shërbejnë në personelin ndërkombëtar të organizatës dhe të paguajë pagat dhe shpërblimet nga fondet e veta sipas një niveli të caktuar nga ai vetë. Pagat dhe shpërblimet e paguara në këtë mënyrë mund të taksohen nga ky Shtet Anëtar por përjashtohen nga taksat e cilitdo Shteti tjetër Anëtar. Në rast se një rregullim i tillë është bërë nga cilido Shtet Anëtar dhe më vonë është modifikuar ose përfunduar, Shtetet Anëtare nuk do të jenë më të detyruara sipas fjalisë së parë të këtij neni për të përjashtuar nga taksat pagat dhe shpërblimet që i paguhen shtetasve të tyre.

Neni 20

Përveç imuniteteve dhe privilegjeve të përcaktuara në nenet XVIII dhe XIX, Sekretarit Ekzekutiv të Organizatës, Koordinatorit të Prodhimit të Mbrojtjes së Atlantikut të Veriut dhe zyrtarëve të tjerë të përhershëm me gradë të ngjashme siç mund të bihet dakord ndërmjet Kryetarit të Përfaqësuesve në Këshill dhe Qeverive të Shteteve Anëtare, do t'u jepen privilegje dhe imunitete që i jepen normalisht personelit diplomatik në gradë të krahasueshme.

Neni 21

1. Ekspertëve (përveç zyrtarëve që parashikohen brenda qëllimit të neneve nga XVIII deri në XX) që janë të punësuar në misione në emër të organizatës do t'u jepen privilegjet dhe imunitetet në vijim për aq sa është e nevojshme për ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tyre, ndërsa janë të pranishëm në territorin e një Shteti Anëtar për kryerjen e detyrave të tyre:

a) Imunitet nga arrestimi apo ndalimi personal si edhe nga sekuestrimi i bagazheve të tyre personale;

b) Në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tyre në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare për organizatën, imunitet nga procesi ligjor;

c) të njëjtat lehtësi në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj dhe në lidhje me bagazhet e tyre siç u janë dhënë zyrtarëve të qeverive të huaja në misione zyrtare të përkohshme;

d) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve që lidhen me punën në të cilën ata janë të përfshirë për organizatën.

2. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill do t'i komunikojë Shteteve Anëtare të interesuara emrat e cilitdo ekspert për të cilin zbatohet ky nen.

Neni 22

Privilegjet dhe imunitetet i jepen zyrtarëve dhe ekspertëve në interes të organizatës jo për përfitimin personal të vetë individëve. Kryetari i Përfaqësuesve në Këshill ka të drejtën dhe detyrimin për të hequr imunitetin e cilitdo zyrtar apo ekspert në cilindo rast kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e organizatës.

Neni 23

Dispozitat e neneve XVIII, XX dhe XXI më lart nuk do t'i kërkojnë asnjë shteti që të japë

cilindo nga privilegjet dhe imunitetet e referuara aty ndaj cilitdo person që është shtetas i vet, përveç:

a) Imunitet nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara dhe me veprimet e kryera prej tij në përmbushje të funksioneve të tij zyrtare për organizatën;

b) paprekshmërinë e të gjitha letrave dhe dokumenteve që lidhen me punën në të cilën ai është i përfshirë për organizatën;

c) lehtësi në lidhje me kufizimet mbi valutën apo këmbimin e saj për aq sa është e nevojshme për ushtrimin e efektshëm të funksioneve të tij.

PJESA V
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 24

Këshilli do të sigurojë mënyrat e përshtatshme të zgjidhjes së:

a) mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kontratat apo mosmarrëveshje të tjera të një karakteri privat në të cilat është palë organizata;

b) mosmarrëveshjeve që përfshijnë cilindo zyrtar apo ekspert të organizatës për të cilin zbatohet pjesa IV e kësaj Marrëveshjeje, i cili, për shkak të pozitës së tij zyrtare, gëzon imunitet; në rast se imuniteti nuk është hequr në përputhje me dispozitat e nenit XXII.

PJESA VI
MARRËVESHJE SHTESË

Neni 25

Këshilli, duke vepruar në emër të organizatës, mund të përfundojë me cilindo Shtet Anëtar apo Shtete Anëtare marrëveshje shtesë që modifikojnë dispozitat e kësaj Marrëveshje, për aq sa mund t'i interesojë atij shteti apo atyre shteteve.

PJESA VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të organizatës dhe do t'i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese për çdo depozitim të tillë.

2. Sapo gjashtë vendet nënshkruese të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në lidhje me ato shtete. Ajo do të hyjë në fuqi në lidhje me çdo shtet tjetër nënshkrues në datën e depozitimit të instrumentit të tij ratifikimit.

Neni 27

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga cilido Shtet Kontraktues duke dhënë një njoftim me shkrim për këtë denoncim drejtuar Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të njoftojë të gjitha Shtetet nënshkruese për çdo njoftim të tillë. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga ana e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e plotfuqishëm kanë nënshkruar këtë Marrëveshje. Bërë në Otava, më 20 shtator 1951, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke qenë të dy tekstet me të

njëjtin autoritet, në një origjinal të vetëm, i cili do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar secilit nga shtetet nënshkruese.